



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**BORDI DISIPLINOR**

**Nr. (•) i Vendimit**

**VENDIM**

**BORDI DISIPLINOR**

i përbërë nga:

<b>Jonida Gaba:</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Entela Memishaj Shehaj:</b>	<b>Sekretar/ Anëtar</b>
<b>Marjana Semini-Tutulani:</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Merita Prifti:</b>	<b>Anëtar</b>

Në seancën e datës (•) mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. (•), datë (•), “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, përcjellë me shkresën “Për përcjellje dokumentacioni” me nr. (•) datë(•), drejtuar Bordit Disiplinor të DHKN, me të dhënat si më poshtë:

<b>KËRKUES:</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>DREJTUAR:</b>	Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë
<b>KUNDËR:</b>	Subjektit të Procedimit (•), Noter
<b>OBJEKTI:</b>	Nisja e procedimit disiplinor për noterin (•) ; Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në gërmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”
<b>BAZA LIGJORE:</b>	Neni 26, 43-55 i Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”

**BORDI DISIPLINOR**

pasi dëgjoi relatimin e Anëtares znj. (•), pasi përfundoi seancën dëgjimore me subjektin e procedimit disiplinor, Noter (•) i dhe me përfaqësuesen e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Znj. (•), Drejtore e Drejtorisë e Përgjithshme Rregullatore të Cështjeve të Drejtësisë dhe, si bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**A. FAKTET**

1. Pranë Bordit Disiplinor në datën (•), është dorëzuar Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. Prot. (•), datë(•), “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•) i”, sipas të cilit urdhërohet: Nisja e procedimit disiplinor për noterin dhe dërgimi i dokumentacionit provues mbi mos përmbushjen e detyrimeve ligjore sipas Urdhrit nr. (•), datë (•) dhe Urdhrit nr. (•), datë (•), Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
2. Bashkalidhur me Urdhrin të Ministrit të Drejtësisë Nr. (•), datë (•), është dërguar edhe dokumentacioni i dosjes hetimore, i cili i është vënë në dispozicion Noterit (•) i në momentin e njoftimit të fillimit të procedimit disiplinor.

3. Noteri (•) i ka qenë subjekt i hetimit disiplinor nga Ministria e Drejtësisë në bazë të Urdhrit nr. (•), datë (•) të Ministrit të Drejtësisë. Mosrespektimi i kërkesave të këtij Urdhëri si dhe i detyrimeve që burojnë nga Ligji nr.9917/2008 *“Për parandalimin e Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”*, ka qenë shkak për marrjen e masës disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për heqje të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit”*, në ngarkim të noterit. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. (•) datë (•) , caktonte një sërë detyrash për noterin për t'u përbushur brenda afatit 30-ditor. Mospërbushja e detyrave të caktuara përbën shkakun kryesor për nisjen e këtij procedimi disiplinor.
4. Me shkresën nr. (•) datë (•) , i është dërguar shkresë noterit (•) i, duke i sjellë në vëmendje se afati për përbushjen e detyrimeve të Urdhrit Nr. (•) ka qenë 30 ditë, ndërkohë kanë kaluar 3 muaj dhe noteri nuk ka informuar Ministrinë, nëse janë përbushur ose jo këto detyrime. Gjithashtu me shkresën nr. (•) datë (•), i bëhet një rikujtesë për këtë fakt.
5. Noteri nuk ka kthyer përgjigje mbi shkresat e mësipërme.
6. Sipas ekstraktit historik të QKB, rezulton se noteri **vazhdon të jetë me status aktiv.**
7. Pas verifikimit në RNSH rezulton se **nuk ka veprime të regjistruara.**
8. Nga ana e noterit, **nuk është bërë ndonjë kërkesë për pezullimin** e ushtrimit të profesionit.
9. Noteri nuk ka kryer ndonjë njoftim për ndërprerje aktiviteti pranë DHKN.
10. **Lidhur me verifikimin e juridiksionit ku ushtrohet veprimtaria noteriale sipas nenit 26, pikat 20 dhe 5) të Ligjit Nr.110/2018, rezuktoi se** Noteri (•) i e ushtron veprimtarinë noteriale në Bashkinë Tiranë.
11. Bordi Disiplinor i DHKN është në ushtrimin e kompetencave të tij për shqyrtimin e procedurës së parashikuar hetimore për Z. (•) i, parashikuar nga neni 26, pikat 2 dhe 5 i Ligjit Nr. 110/2018
12. **Lidhur me verifikimin e respektimit të detyrimeve në përpilimin e akteve noteriale konform Ligjit Nr. 110/2018, “Për Noterinë”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore**, u vërejt se janë redaktuar akte deri në datë (•), por nuk janë pasqyruar në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale. U analizuan vetëm tre akte për të cilat mungon fotokopja e ID-së së shtetasve, nuk ka referencë në bazën ligjore, mungon fotokopja e faturës tatimore. Këto akte janë: Prokura e posacme, Nr. (•) datë (•), Deklarata noteriale, Nr. (•), datë (•) dhe Prokura e posacme me Nr. (•), datë (•).
13. Nga pyetja që ju bë noterit (•) në seancën dëgjimore lidhur me natyrën e akteve të tjera të përgatitura prej tij, nuk rezultoi të jepej prej tij një listë më e plotë e llojit këtyre akteve, i natyrës apo përmbajtjes së tyre. Nga parashtrimet e Noterit, rezulton se ai ka vështirësi në pranimin e përgjegjësive ligjore që lidhen me ushtrimin e detyrës së noterit.
14. **Lidhur me verifikimin e regjistrit të përgjithshëm i akteve dhe veprimeve noteriale dhe të tarifave përkatëse, konform Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr.6291/2008, “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar**, rezultoi se: Mungon dhe nuk u vu në dispozicion arkiva e noterit; Nuk ndodhej në zyrën noteriale Regjistri i Përgjithshëm i akteve dhe veprimeve noteriale; Tre regjistrat e tjerë

rezulton se janë të hequr nga noteri në vitin 2011; Nga faqja e parë dhe e fundit u konstatua se nuk është hedhur në to asnjë e dhënë; Po ashtu, pas verifikimit të indeksit alfabetik, rezulton se nga viti 2011 nuk është hedhur asnjë e dhënë; Zyra ka një kontratë qiraje që i ka kaluar afati ne (•) dhe nuk është rinovuar; Mungon kasaforta; Nuk është lidhur kontratë sigurimi për shkaktimin e dëmeve të noterit ndaj të tretëve, etj.

15. **Lidhur me verifikimin e respektimit të detyrimit të Noterit për hedhjen në sistem të akteve noteriale, në zbatim të VKM-së Nr. 304/2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)”** rezulton se RNSH nuk është instaluar nga noteri dhe nuk është hedhur asnjë e dhënë, që nga fillimi i funksionimit të RNSH-së.
16. **Lidhur me verifikimin e respektimit të detyrimit të Noterit në kuadër të Ligjit Nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, konstatohet se:** Noteri (•) i nuk i ka përmbushur detyrimet që burojnë nga ligji për vënien në dispozicion të çdo informacioni apo dokumenti të kërkuar nga DPPP.

## B. Analiza ligjore

17. Në seancën dëgjimore të datës (•) , mbajtur në prani të Noterit (•) i, në kuptim të nenit 43 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, njoftuar rregullisht tek ky Noter, Bordi Disiplinor u njoh me parashtresën mbrojtëse të Noterit (•) i. Kjo parashtresë u paraqit edhe me shkrim. Argumentat mbrojtëse të Noterit, konsistojnë në: paraqitjen e historikut të jetës personale dhe profesionale të Noterisë; paraqitjen e vlerësimit të Noterit për këndvështrimin e tij ligjor lidhur me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara nga Noteri dhe rëndësinë e akteve dhe regjistrave të depozituara në zyrën noteriale dhe, paraqitjen e vlerësimit të noterit lidhur me veprime e sjellje të kryera grupit të Kontrollit dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të DPPP.
18. Lidhur me **verifikimin e zyrës së noterisë**, me verifikimin e arkivit dhe regjistrat regjistrave manualë u konstatua se janë cenuar dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore: pika 21 e Ligjit për Noterinë; pikat 6, 9, 10/d/dh, 18 e Urdhërit 8046/2004 e Ministrit të Drejtësisë; pika 9 e Urdhërit 8046/2004 e Ministrit të Drejtësisë dhe Neni 70 i Ligjit 7829/1994;
19. Lidhur me **hedhjen në sistem të akteve noteriale** u konstatua se janë cenuar dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore: VKM 304/2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore...” dhe Urdhëri 88/2013 “Për përdorimin e Regjistrat Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)”
20. Lidhur me **verifikimin e respektimit të detyrimeve që burojnë nga ligji 9917/2008 për parandalimin e pastrimit të parave**, noteri (•) i nuk pranoi se ka detyrim ligjor për të deklaruar ose sinjalizuar transaksionet që kryhen pranë zyrës së tij, prandaj a nuk ka mbushur dhe dorëzuar formularët përkatës. Lidhur me këtë detyrim u konstatua se janë cenuar dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore: Pika 3/gj e Ligjit Nr. 9917/2008; Neni 13, Udhëzimi Nr. 29/2012 i Ministrisë së Financave dhe Neni 22, Ligji Nr. 7829/1994 “Për noterinë” i ndryshuar.
21. **Lidhur me pagesat e kuotave pranë DHKN, rezultoi se noteri (•) nuk ka kryer pagesat e kuotave duke cenuar Nenin 23 ligji 7829/1994.**

## C. Vlerësimi i Bordit Disiplinor

22. Bordi Disiplinor vlerëson se janë kushtet për fillimin dhe vijimin e procedurës disiplinore sipas Urdhrit Nr. (•), Nr. (•) Prot, datë të Ministrit të Drejtësisë.
23. Seanca disiplinore është mbajtur si seancë publike, më (•). Përbërja e Bordit Disiplinor ka qënë me katër anëtarë nga pesë që e ka përbërjen e tij, për shkak se Zj. (•), anëtare e Bordit Disiplinor, nuk ka mundur të marrë pjesë në këtë proces për arsye familjare emergjente. Për rrjedhojë, Bordi Disiplinor ka kryer procedurën me shumicën e tij në përputhje me parashikimin e nenit 42, paragrafi 11 të të njëjtin Ligj dhe në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.
24. Fillimi i procedurës disiplinore ndaj Noterit (•) i ka nisur nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin Nr. (•), datë (•), “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)” në kuptim të gërmës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.
25. Nga Raporti i Hetimit dhe dosja hetimore e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se hetimi për shkeljen e pretenduar është kryer brenda afatit ligjor (6 muaj) nga marrja e vendimit për fillimin e hetimit.
26. Shkeljet e konstatuar nga Raporti Hetimor, janë (•): **mosushtrimi i veprimtarisë së rregullt noteriale që lidhet me parregullsi të administrimit zyrës noteriale, duke mos kryer sigurim fizik të zyrës, etj; nuk është lidhur kontratë sigurimi për shkaktimin e dëmeve të noterit ndaj të tretëve; mungon tabela me shënimin “NOTER”, (për të lehtësuar aksesin e klientëve në zyrën noteriale); parregullsi që lidhen me mosmbajtjen e arkivës dhe të rregjistrave manualë të noterit, moshedhjen e të akteve dhe dhënave në sistemin e RNSH, mospërbushja e detyrimeve që burojnë nga ligji për vënien në dispozicion të çdo informacioni apo dokumenti të kërkuar nga DPPP, mospërbushja e detyrimeve në afatin 30 ditor të përcaktuar në Urdhërin për dhënien e një mase më të lehtë, mungon dhe nuk u vu në dispozicion arkiva e noterit; etj.**
27. Ministria e Drejtësisë ka proceduar fillimisht me një masë më të lehtë duke i dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për heqje të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit”, Detyrimet e caktuara nga Urdhëri përkatës nuk u zbatuan nga Noteri dhe kjo mospërbushje përbën një shkelje shumë të rëndë, e cila passjell dhënien e një mase më të rëndë disiplinore.
28. Bordi Disiplinor pasi analizoi me kujdes faktet, bazën ligjore dhe raportin e Ministrisë së Drejtësisë, pasi dëgjoji parashtrimet e Noterit dhe të përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë në seancën dëgjimore,

#### **Konstaton se:**

- 28.1 Noteri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përmbushjen e detyrave që janë lënë në bazë të Urdhërit të Ministrisë së Drejtësisë me Nr. (•), datë (•) dhe dëshmon një qendrim totalisht të paimentuar për të njohur, kuptuar dhe zbatuar detyrimet ligjore që lidhen me: hedhjen e të akteve dhe dhënave në sistemin e RNSH; përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe kërkesat e DPPP dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e noterisë;
- 28.2 Noteri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rivendosjen në vënd të shkeljeve që janë konstatuar nga Raporti i Grupit të Kontrollit dhe nga Urdhëri i Ministrisë së Drejtësisë me Nr. (•) datë (•).

Duke mos pasur arkivën e nevojshme dhe pajisjet e sigurta ose kasafortat për mbajtjen e dokumentacionit arkivor, noteri cënon rëndë funksionet e profesionit që ushtron.

28.3 Lidhur me natyrën e shkeljeve, Bordi Disiplinor konkludon se shkeljet e konstatuara nga Raporti i Grupit të Kontrollit, që kanë cuar Ministrinë e Drejtësisë në nxjerrjen e Urdhërit Nr. (•) datë (•) përbëjnë shkelje të rënda. Në kuptim të nenit të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, sipas të cilit masa disiplinore e dhënë ndaj një noteri jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret që lidhen me shkallën e pakujdesisë; shpeshtësinë e kryerjes së gabimit, etj

28.4 Për sa më sipër, Bordi Disiplinor konkludon që ta konsiderojë shumë të rëndë shkeljen e demonstruar nga noteri (•) i, duke vlerësuar edhe faktin e përsëritjes së shkeljes disiplinore në mënyrë të shkallëzuar, brenda një periudhe të shkurtër kohore nga dhënia e masës së parë disiplinore.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë, mbështetur në nenin 51 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Udhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170 datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores dhe skemën e kompesimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”

### **VENDOSI<sup>1</sup>:**

1. Pranimin e kërkesës të Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noterit (•) i;
2. Lënien në fuqi të masës së propozuar nga nga Ministri i Drejtësisë sipas gërmës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2021 “Për Noterinë”;
3. Heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së Noterit (•).
4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë, që të bëjë publikimin e këtij vendimi dhe ta rregjistrojë atë në rregjistrin e masave disiplinore.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall, në datë (•), në Tiranë.

**Bordi Disiplinor  
Dhoma Kombetare e Noterise**

**Jonida Gaba  
Kryetare**

**Entela Memishaj Shehaj  
Sekretare/Anëtare**

---

<sup>1</sup> Vendimi i Bordit Disiplinor merret me katër vota pro.